



01/Nr.6898/2017

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 24, 40, Ligjin nr.05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017 neni 2, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit Nr. 03/L-48 neni 20, Qarkoret Buxhetore 2018/01 dhe 02 për Komunat, Kuvendi i Komunës së Hani të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 21.09.2017 merr:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E BUXHETIT PËR VITIN 2018 DHE PARASHIKIMET BUXHETORE PËR VITET 2019-2020 TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT

I

Kuvendi i komunës miratoi vendimin për buxhetin e Komunës për vitin 2018, në shumë prej 2,716,597 €, ndërsa parashikimet buxhetore për vitin 2019 janë në shumë prej 2,930,065 € dhe për vitin 2020 janë në shumë prej 2,727,751 €.

II

Në strukturën e të hyrave të tërësishme buxhetore për vitin 2018 sipas pikës I të këtij vendimi, mjetet nga grantet qeveritare (granti i përgjithshëm, granti i arsimit dhe granti i shëndetësisë) janë në shumë prej 2,407,494 €, që shënojnë pjesëmarrje prej 88.62%, mjetet nga të hyrat vetanake komunale janë në shumë prej 303,597 € apo 11.18%, ndërsa mjetet nga huamarrja për arsim janë në shumë prej 5,506 € apo 0.20%.

III

Shpenzimet e përgjithshme buxhetore për vitin 2018 sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve parashikohen të kenë këto ndarje buxhetore: Paga dhe mëditje 1,394,059 €, Mallra dhe shërbime 225,312 €, Shpenzime Komunale 44,533 €, Subvencione dhe transfere 51,104 € dhe Shpenzime kapitale 1,001,590 €.

IV

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës-MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës .

V

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Ministria e Financave-Departamenti i Buxhetit, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 21.09.2017





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr.7006/2017

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, neni 11, 40, 68, Ligjit për Qasje në Dokumente Publike Nr. 03/L-215, Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna Nr.01/2015, Statuti i Komunës së Hanit të Elezit, Kapitulli -I- Konsultime me Publikun, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 21.09.2017 merr:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS PËR TRANSPARENCË PËR VITIN 2018

I

Kuvendi i Komunës miratoi vendimin për planin e punës për transparencë për vitin 2018.

II

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është plani i punës për transparencë për vitin 2018.

III

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës –MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

IV

Me këtë vendimi njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Administratës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 21.09.2017





01/ Nr.6880 /2017

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale numër Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës neni 15, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 21.09.2017 merr:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2018

I

Kuvendi i komunës miratoi vendimin për planin e punës së kuvendit të komunës së Hani të Elezit për vitin 2018.

II

Kuvendi i Komunës së Hani të Elezit për vitin 2018 planifikon t'i mbajë gjithsej dymbëdhjetë mbledhje të rregullta dhe çdo mbledhje të kuvendit i paraprin mbledhja e komitetit për politik dhe financa.

III

Mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës së Hani të Elezit, do të mbahen sipas periudhës kohore të paraqitura si në tabelë:

	Vendimet/Çështjet	
JANAR 2018	- Miratimi i planit të punës së komitetit për komunitete për vitin 2018. - Miratimi i planit të punës së tri komiteteve konsultative për vitin 2018. - Miratimi i planit të punës së këshillave të fshatrave për vitin 2018. - Miratimi i planit të punës së këshillit komunal për siguri në bashkësi 2018. - Shqyrtimi i progresit të adresimit të rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm sipas planit të veprimit. - Informatë mbi veprimtarit afariste. - Miratimi i propozim vendimit për ndarje e bursave për student.	
SHKURT 2018	- Shqyrtimi i raportit të punës së kryetarit të komunës për vitin 2017. - Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2017. - Miratimi i raportit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2017. - Miratimi i propozim vendimit për bartjen (rialokimi) e buxhetit të pashpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual. - Shqyrtimi i informatës mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2017-2018.	

MARS 2018	• Shqyrtimi i raportit të punës së komitetit për komunitete për vitin 2017. • Shqyrtimi i raportit të punës së tri komiteteve konsultative për vitin 2017. • Shqyrtimi i njoftimit për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2017. • Shqyrtimi i njoftimit për aktivitetet e këshillave të fshatrave të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2017.	
PRILL 2018	• Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar – Mars 2018. • Shqyrtimi i informatës mbi ndarjen e bursave. • Shqyrtimi i raportit tre mujor i N.P.L "Pastrimi" Sh.a. • Shqyrtimi i raportit mbi vlerësimin e performances së Komunës për vitin 2017. • Shqyrtimi i raportit monitorues për zbatimin e qëllimeve dhe objektivave nga PZHK, PU dhe PRR për vitin paraprak.	
MAJ 2018	• Miratimi i rishikimit të buxhetit të komunës për vitin 2018. • Shqyrtimi i informatës mbi mbrojtjen e mjedisit. • Miratimi i propozim vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për "Javën Kulturore" 2018.	
QERSHOR 2018	• Miratimi i kornizës afatmesme buxhetore 2019-2021. • Shqyrtimi i informatës mbi sektorin e emergjencave.	
KORRIK 2018	• Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar – Qershor 2017. • Shqyrtimi i informatës mbi raportin e auditorit të përgjithshëm për Komunën për vitin 2017. • Shqyrtimi i planit të veprimit të Komunës së Hanit të Elezit për adresimin e rekomandimeve të raportit të auditimit 2017. • Informatë mbi procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre. • Miratimi i propozim vendimit për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së kuvendit të Komunës për vitin 2019. • Shqyrtimi i njoftimit për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për gjashtë mujorin e vitit 2018. • Shqyrtimi i raportit gjashtë mujor i N.P.L "Pastrimi" Sh.a.	
GUSHT 2018	• Shqyrtimi i raportit të punës së kryetarit të komunës për periudhën Janar - Qershor 2018. • Shqyrtimi i informatës mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2017-2018. • Shqyrtimi i rregullores për tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin 2019. • Shqyrtimi i rregullores për taksa, tarifa dhe gjoba komunale për vitin 2019. • Shqyrtimi i informatës mbi raportin e shpenzimeve për "Javën Kulturore" 2018. • Informatë mbi Qarkoren e dytë të brendshme buxhetore. • Informatë për korrje shirjet.	

SHTATOR 2018	• Miratimi i buxhetit të komunës për vitin 2019 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2020-2021. • Miratimi i rregullores për tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin 2019. • Miratimi i rregullores për taksa, tarifa dhe gjoba komunale për vitin 2019. • Miratimi i planit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2019. • Informatë mbi realizimin e planit të prokurimit për vitin 2018 • Shqyrtimi i informatës mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2018/2019.	
TETOR 2018	• Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar – Shtator 2018. • Shqyrtimi i raporti të DKA-së mbi suksesin e arritur për fundin e vitit shkollor 2016/2017 në SHFMU dhe SHML. • Shqyrtimi i raportit nëntë mujor i N.P.L "Pastrimi" Sh.a.	
NËNTOR 2018	• Shqyrtimi i informatës mbi ndarjen e subvencioneve në bujqësi. • Shqyrtimi i informatës mbi gjendjen në shëndetësi.	
DHJETOR 2018	• Informatë e kryetarit mbi planin punës së ekzekutivit për vitin 2019. • Miratimi i planit për transparencë për vitin 2019.	

IV

Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit gjatë vitit 2018, mund të mbajë edhe mbledhje tjera të rregullta më shumë se minimumi i paraparë me aktet në fuqi. Të gjitha mbledhjet e rregullta do të mbahen vetëm ditëve të punës.

V

Të gjitha mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës do të jenë të hapura për qytetarë dhe përfaqësues të mediave publike. Nëse ndonjë mbledhje e rregullt apo pjesë e mbledhjes do të mbahet me dyer të mbyllura atëherë për këtë duhet të vendosë Kuvendi i Komunës. Nëse mbledhja mbahet me dyer të hapura në mbledhjet mund të marrin pjesë qytetarët e komunës dhe përfaqësues të mediave në përputhje me kushtet dhe mundësitë fizike.

VI

Kuvendi i komunës mund të mbajë edhe mbledhje tjera, varësisht prej nevojave që paraqiten.

VII

Njoftimet për mbledhje të kuvendit të komunës bëhen publike. Materialet për mbledhjet e rregullta të kuvendit të komunës iu dorëzohen të gjithë anëtarëve të kuvendit të komunës 7 ditë pune para mbajtjes së mbledhjes. Njoftimet dhe materiali i mbledhjes i dërgohet edhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

VIII

Plani i mbledhjeve të kuvendit, i përcaktuar si në pikën III të këtij vendimi, është orientues e nuk do të thotë se nuk pëson ndryshime.

IX

Plani i mbledhjeve të kuvendit të komunës për vitin 2018, ka fuqi veprimi nga muaji Janar deri në muajin Dhjetorë të vitit 2018.

X

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

XI

Me këtë vendim njoftohet: Kryetari i Komunës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Shërbimi i Arkivit të Komunës.

Hani i Elezit

Data: 21.09.2017





Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/ Nr. 7581/2017

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 12.2 shkronja (d), 40, Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 21.09.2017 merr:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË PËR ZHVILLIM SOCIAL – EKONOMIK TË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2018-2022

I

Kuvendi i komunës miratoi vendimin për strategjinë për zhvillim social –ekonomik të Hanit të Elezit për vitin 2018-2022.

II

Miratimi i këtij vendimi vjen pas propozimit të ekzekutivit të komunës dhe pas zhvillimit të gjithave procedurave ligjore. Strategjia për Zhvillim Socio-Ekonomik të Hanit të Elezit hartohet me qëllim të udhëheqjes, mundësimit dhe promovimit të një zhvillimi integrues, gjithpërfshirës dhe të qëndrueshëm të Komunës së Hanit të Elezit, e cila përmban gjithsej 48 (katër dhjet e tetë) faqe dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

III

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës-MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

IV

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit

Data: 21.09.2017



Kryesuesi i Kuvendit
Qamush Brava